



Prishtinë: 24.09.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1045/1_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1840_08_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **04.09.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 24.09.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Rr. A. fshati Petrovë, Shtime, me shifër të konsumatorit: DFE - 132310, si e pa bazuar.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1840_08_18 i datës 06.08.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 04.09.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se fatura e muajit 03/2013 është në rregull dhe e bazuar në procesverbalin e qendrës së kalibrimit. Në ankesë është theksuar se analiza e DMK rreth krahasimit të shpenzimeve nuk mund të merren si të sakta, pasi me njehsor të ndryshëm ka shpenzim të ndryshëm. Në ankesë është theksuar se pretendimi se fatura 03/2013 nuk paraqet shpenzim real mujor nuk është i saktë pasi që sipas procesverbalit të kalibrimit njehsori është brenda kufijve të lejuar. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1840_08_18 i datës 06.08.2018 për konsumatorin Rr. A. me shifër DFE - 132310.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se fatura e muajit 03/2013 është në rregull dhe e bazuar në procesverbalin e qendrës së kalibrimit, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë shqyrtimit të lëndëve të konsumatorit nuk mund të merret për bazë vetëm procesverbalin e kalibrimit si procesverbal meritor pa u shqyrtuar edhe dëshmitë tjera. Bordi i ZRRE-së thekson se DMK shpenzimi



i faturuar i KESCVO për konsumatorin për periudhën 03/2013 ka qenë 7340 kWh, ndërsa në asnjë muaj tjerë as për së afërmi nuk kemi shpenzim të ngjashëm të konsumatorit, andaj bazuar në analizat e bëra konstaton se konsumatori në periudha kontestuese 03/2013 nuk është faturuar me shpenzimet reale për shkak të mos matjes së saktë të njehsorit elektrik.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se analiza e DMK rreth krahasimit të shpenzimeve nuk mund të merren si të sakta, pasi me njehsor të ndryshëm ka shpenzim të ndryshëm, Bordi i ZRRE-së thekson se kjo nuk qëndron, pasi që bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike, por që gjatë krahasimit të shpenzimeve të energjisë elektrike për periudhën kontestuese me periudhat e njëjta të më hershme dhe të mëvonshme me tre njehsorët elektrik, njehsorin elektrik kontestues nr.07779665, njehsorin elektrik nr.04661737 si dhe njehsorin e ri elektrik nr.30511267, ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike vetëm në periudhën 03/2013 me njehsorin kontestues. Këtë fakt e dëshmon më që qarti shpenzimi i energjisë elektrike i konsumatorit për periudhat e më hershme me njehsorin elektrik kontestues nr.07779665: periudha 03/2011 është 569 kWh, periudha 03/2012 është 650 kWh, periudha 03/2013 është 7,340 kWh, me njehsorin elektrik nr. 04661737: periudha 03/2014 është 648 kWh, 03/2015 është 565 kWh dhe 03/2016 është 467 kWh kurse me njehsorin elektrik nr.30511267: periudha 03/2017 është 443 kWh dhe 03/2018 është 440 kWh. Sipas shpenzimeve të paraqitura më lartë Bordi i ZRRE-së thekson se shpenzimi i muajit 03/2013 nuk paraqet shpenzim real mujor, pasi që edhe shpenzimi i përgjithshëm i energjisë elektrike sipas viteve nuk është sa shpenzimi i muajit 03/2013. Shpenzim i përgjithshëm i energjisë elektrik i konsumatorit sipas viteve është: 2010 – 7009 kWh, 2011 – 7039 kWh, 2012 – 7014 kWh, 2013 – 17127 kWh (këtu përshihet edhe periudha kontestuese), 2014 – 6750 kWh, 2015 – 5998 kWh, 2016 – 5520 kWh dhe 2017 – 5190 kWh.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se pretendimi i organi të shkallës së fatura 03/2013 nuk paraqet shpenzim real mujor nuk është i saktë, Bordi i ZRRE-së thekson se konstatimi i organit të shkallës së parë është i saktë dhe kjo bazuar në analizën e rrjedhës se energjisë elektrik me tre njehsorët elektrik, ku është vërejtur se shpenzimet e faturuar me njehsorin elektrik nr.07779665 për periudhën mars 2013 nuk paraqesin shpenzime reale mujor të konsumatorit pasi që ndryshimi i kWh të faturuar për periudha të njëjta të më hershme si dhe të mëvonshme me dy njehsorët e tjerë nr.04661737 si dhe njehsorin e ri elektrik nr.30511267 është shumë i madh. Andaj bazuar në këto të gjetura Bordi i ZRRE-së konstaton se konsumatorit duhet t'i bëhet anulimi i faturës për periudhën mars 2013 me njehsorin elektrik nr. 07779665 duke e faturuar konsumatorin me shpenzimet e njehsorit nr. 04661737 te periudhës 03/2014 ku TL= 514 kWh dhe TU= 134 kWh

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit Rr. A. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.